

**AKTI I THEMELIMIT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

RentX shpk

Sot, në Tiranë, më datë 06/03/2023

- a) **Z.Ledio Dyrmishi**, shtetas shqiptar, lindur me 08.06.1998, ne Terpan, Berat, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, banues ne Kashar, Tirane, mbajtes i letërnjoftimit J80608057F;
- b) **Z. Aleksander Ndoci**, shtetas shqiptar, lindur me 19.09.1998, ne Puke, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, banues ne Lanabreges, Tirane, mbajtes i letërnjoftimit J80919037J.

Në cilësinë e Ortakëve Themelues të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “RentX ” shpk. Personat e mësipërm janë madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar. Ata me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, nëpërmjet këtij akti themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe kushteve të mëposhtme.

Neni 1

Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është “RentX”, që më poshtë do të quhet “RentX”, ose “Shoqëria”.

Neni 2

Objekti

2.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të përfshijë:


- a) Ofrimin e shërbimit të aplikacionit “RentX”, si aplikacion për dhënien me qira të automjeteve i krijuar bashkërisht nga themeluesit;
- b) Ofrimin e shërbimeve në fushën e marketingut për subjektet juridikë të cilët ushtrojnë aktivitetin në fushën e dhënies së automjeteve me qira dhe jo vetëm.

2.2 Shoqëria do të kryejë çdo veprimtari të lejuar nga ligji dhe/ose pjesëmarrjen në çdo veprim apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar në baze të legjislacionit shqiptar, për fushën e teknologjisë së informacionit.

Neni 3

Selia

3.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën Rruga “Kajo Karafili”, pallati “Bimbashi”, Hyrja 3,



Apartamenti 2, Njësia Administrative nr. 10.

- 3.2 Adresa e shoqërisë për qëllime të komunikimit elektronik është si vijon: email: contact@rentx.al
- 3.3 Shoqëria mund të hapë edhe zyrë përfaqësimi, dege, të krijojë filiale dhe/ose të realizojë çdo lloj pjesëmarrje në shoqëri të tjera, siç parashikohet nga ligji, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve të marre me shumicë të thjeshtë votash.

Neni 4

Kohezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin që ka për objekt për një periudhë kohore me afat të pacaktuar.

Neni 5

Kapitali Themeltar


- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuara është 100 (njëqind) lekë i ndarë në 100 (njëqind) pjesë me vlerë nga 1 (një) Lekë secila. Themeluesit i marrin në pronësi kuotat e tyre të kapitalit themeltar në përputhje me kontributin e tyre, si vijon:
- a) Z. Ledio Dyrmishi, zotëron 45 (dyzetë e pesë) pjesë të kapitalit, e barabartë me 45% (dyzetë e pesë për qind) të kapitalit, me vlerë të përgjithshme, 45 Lekë (dyzetë e pesë);
 - b) Z. Aleksander Ndoci zotëron 55 (pesëdhjetë e pesë) pjesë të kapitalit, e barabartë me 55% (pesëdhjetë e përqind) të kapitalit, me vlerë të përgjithshme, 55 Lekë (pesëdhjetë e pesë);

Shuma gjithsej e kapitalit themeltar: 100 (njëqind) lekë.

5.2 Pjesët e kapitalit janë lirish të transferueshme në çdo moment sipas kushteve të parashikuara nga ligji shqiptar, me kufizimet e përcaktuara në pikat 5.3 dhe 5.4 me poshtë.

5.3 Në rast se njëri nga ortakët kërkon të shesë një pjesë ose të gjitha kuotat që ai zotëron në shoqëri, ai është i detyruar që t'ia ofrojë paraprakisht këto kuota ortakëve të tjerë të shoqërisë, ose vetë shoqërisë me të njëjtin cmim që ai ka vendosur t'ia shesë ato. Kjo ofertë do të quhet e marre nga ortakët e tjerë dhe/ose nga shoqëria, në momentin e depozitimit të saj në seline të shoqërisë.

5.4 Në rast se ortakët e tjerë të shoqërisë, ose shoqëria, brenda 3 muajve nga data e depozitimit të ofertës nuk përgjigjen për këto oferta, ose refuzojnë ofertën, ortakët ofertues ka të drejtë t'ia shesë lirish kuotat e tij paleve të treta.



Neni 6
Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga Administratori i Vetem. Administratori do të mbajë mandatin e tij për një periudhë pesë vjeçare, me të drejtë të pakufizuar të rinovimit të mandatit. Administratori emërohet me shumicë të thjeshtë votash. Ripërtëritja e mandatit do të bëhet me një vendim të ri të Asamblesë së Përgjithshme, në përfundim të mandatit të parë.

Administrator i parë i shoqërisë do të emërohet:

Z. Aleksander Ndoci, shtetas shqiptar, lindur me 19.09.1998, ne Puke, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, banues ne Lanabreges, Dajt, Tirane, rruga "Mehmet Gjuzi", banesë private nr.28/1 mbajtes i letërnjoftimit J80919037J.

Neni 7
Pergjegjësia Personale

Prona personale e ortakeve, administratorëve, punonjesve dhe/ose agjenteve të Shoqërisë, eshte e perjashtuar nga çfaredo lloj detyrimi qe rendon mbi Shoqerine.

Neni 8
Dispozita Operative

Klauzolat për zhvillimin, rregullimin dhe drejtimin e aktivitetit ekonomik dhe punëve të brendshme të Shoqërisë do të përcaktohen në Statutin e Shoqërisë, i cili mund të ndryshohet në çdo kohë me vendim të kualifikuar të Asamblesë së Përgjithshme.


Neni 9
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar dhe mbaron me 31 dhjetor 2023.

Nenshkruar nga ne ortaket themelues sot me date 06/03/2023.

ORTAKET

Ledio Dyrmishi



Aleksander Ndoci

